

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë!

Buxheti është akti i dytë më i rëndësishëm që paraqet një qeveri në Kuvend, por duket qartësisht edhe respekti i qeverisë për Kuvendin, por edhe për punën e vet, sepse prezenca e saj është pothuajse inekzistente ose krejt, krejt minimale. Ky parlament duhet ta shohë buxhetin me sytë e fermerëve që protestuan sot, të bizneseve që po shkatërrohen, të shqiptarëve që largohen, të papunëve, pensionistëve, sidomos rinisë. Kërkesat e këtyre fermerëve janë që të vlerësohen puna dhe munda e tyre. Sektori i bujqësisë siguron 21% të PBB-së, ndërsa merr si shkëmbim injorimin total nga ana e qeverisë. Kërkojnë një shtet që të mendojë për ta dhe jo t'i lërë në mëshirën e fatit. Shqipëria, të nderuar kolegë deputetë, po varfërohet ekonomikisht vit pas viti. Varfërimi shoqëror, intelektual dhe politik për shkak të largimit masiv të profesionistëve dhe të rinjve, po shkatërron të sotmen e të ardhmen e këtij vendi. Varfëria dhe largimi nga Shqipëria ka në bazë mosqeverisjen, politikën shpërfillëse, përjashtuese dhe konfliktuale, dominimin e korrupsionit dhe të kimit. Shqiptarët kanë hyrë në një proces varfërimi, që duket sikur është pa kthim dhe i vazhdueshëm. Sipas Bankës Botërore, kriza ekonomike globale çon në reduktim të të ardhurave. Sipas vlerësimeve të kryera prej tyre, shkalla e varfërisë në Shqipëri mund të rritet duke shkuar në rreth 40-44%, më e larta se në të gjitha vendet e rajonit.

Kështu, pra, sipas skenarit më pesimist, ajo do të ishte e barabartë me nivelin e vitit 2005. Buxheti nuk reflekton rekomandimet e FMN-së që thekson: "Duhet rritur cilësia dhe transparencja e shpenzimeve publike". Misioni i FMN-së shprehet: "Është e rëndësishme që Shqipëria t'i shtojë përpjekjet për të forcuar sundimin e ligjit, të ulë dobësitë që burojnë nga korrupsioni, të rrisë konkurrueshmërinë që të mbështesë realizimin e qëllimeve dhe aspiratave të saj të zhvillimit afatgjatë". Shqipëria ka një nga standardet më të ulëta të jetesës dhe të ardhurat më të ulëta për frymë në të gjithë Europën. 37% e popullsisë së saj jeton me më pak se 5 dollarë në ditë. Ndërkohë, të ardhurat për frymë janë më të ulëtat në rajon. Nuk krahasohemi me asnjë nga vendet e rajonit për mbledhjen e të ardhurave. Realizimi i të ardhurave në Shqipëri është 24- 28% e vlerës së PBB-së. Ndërsa vendet fqinje me strukturë të ngjashme ekonomike dhe fiskale me tonën, si Serbia, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi grumbullojnë 37-43% të vlerës së PBB-së. Nga një vlerësim i Komisionit Europian për Shqipërinë thuhet se sfidat kryesore, me të cilat përballet dhe do të përballet Shqipëria janë si më poshtë: rritja e deficitit fiskal dhe nevoja për uljen e borxhit publik shumë të lartë. Borxhi duhet të ulet, duke siguruar një rritje të qëndrueshme të të ardhurave tatimore, duke luftuar evazionin fiskal. Rimbursimet e TVSH-së duhet të paguhen brenda afatit ligjor për të dhënë një të ardhur tatimore neto të besueshme. Shqipëria duhet të rrisë kapacitetin e saj institucional për të kontrolluar rreziqet fiskale që rrjedhin nga PPP-të dhe koncesionet.

Qeveria duhet të trajtojë detyrimet e larta të pagesave të prapambetura të sektorit publik dhe të përmirësojë menaxhimin e investimeve publike, sepse po minojnë biznesin. Mjedisi i biznesit në Shqipëri pengohet nga dobësitë strukturore. Zhvillimi i sektorit privat mbetet nën potencialin e tij dhe për përmirësimin e mjedisit të biznesit mungojnë instrumentet efektive të politikave dhe një qasje me

interes strategjik. Shkalla e lartë e informalitetit pengon aksesin në financat për sektorin privat. Pengesë kryesore ngelet shkalla e lartë e korrupsionit në Shqipëri. Qeveria kërkon vetëm pushtetin dhe për pushtetin ajo po rrënon financat publike për një periudhë afatgjatë me një kosto për ne sot dhe për fëmijët tanë nesër. Kjo lexohet qartë edhe në buxhetin e vitit 2022, i cili bazohet në rritjen e borxhit publik. Deficiti buxhetor është parashikuar rreth 1 miliard dollarë ose 5,4% e PBB-së.

Kështu, në vitin 2022 shqiptarët do të paguajnë koston e borxhit të krijuar gjatë gjithë periudhës së kësaj qeverie, i cili ka arritur në nivelet rreth 90%. Për më keq, rritja e borxhit, siç kemi bërë në të gjitha këto kohë me vendimet tona në parlament, nuk do të shkojë aspak për investime që ndihmojnë rritjen dhe zhvillimin ekonomik, sepse investimet publike në vitin 2022, sipas këtij buxheti, do të ulen me 14 miliardë lekë. Po ashtu, edhe nëse shikojmë më tej kategorizimin e investimeve në këtë buxhet, përveç uljes totale, ato do të shpenzohen pa efektivitet, sepse në totalin e investimeve të parashikuara 25% janë investime qeveritare luksi për automjete, rikonstruksione, pajisje zyrahe e të tjera. 14% janë për PPP-të, si dhe 40% të mbetura për investimet të tjera publike, të cilat jo në vlerësimin tim, as të opozitës, por, sipas vlerësimeve të institucioneve financiare ndërkombëtare, përfundojnë në marrëdhënie klienteliste të qeverisë, siç theksoi edhe FMN-ja gjatë vizitës në tetor të këtij viti. Ndërsa investimet ulen 14 miliardë lekë, shpenzimet qeveritare do të rriten me 38 miliardë lekë. Kështu, shqiptarët në vitin 2022 do të paguajnë 12 miliardë lekë më shumë për mbajtjen e administratës qeveritare politike, e cila u rrit artificialisht gjatë zgjedhjeve. 7 miliardë më shumë do të paguhet për interesat e borxhit publik dhe 7 miliardë lekë më shumë për koncesionet e sektorit të shëndetësisë.

Të marra të gjitha së bashku janë më tepër sesa pretendohet që të rriten pagat apo të indeksohen pensionet. Rritja e pakontrolluar e shpenzimeve, të nderuar kolegë, është shumë e lartë, po të krahasohet me mundësitë dhe rritjen ekonomike të vendit tonë në vitin 2022. Këto rritje janë shqetësuese, po të kemi parasysh faktin që në dy dekadat e fundit të gjitha qeveritë kanë tentuar uljen e borxhit publik dhe uljen graduale të shpenzimeve operative të qeverisë dhe kostove të borxhit publik, në raport me PBB-në. Shqipëria varfërohet, ndërsa qeveria bëhet gjithnjë edhe më e madhe, me agjenci të cilat vetëm shërbim nuk kanë, por janë joefikase dhe rritin numrin e punonjësve të qeverisë për interesa politike, të cilat do të paguhet nga buxheti, pra rreth 2500 punonjës. U fol se do të rriten pagat, por si do të rriten ato? Në vitin 2021 kishim afërsisht 75 milionë dollarë për paga dhe dëmshpërblime, në vitin 2022 janë parashikuar vetëm 20 milionë dollarë për indeksime dhe rregullime pagash. Pra, 50 milionë dollarë më pak. Po ashtu, ndërsa çmimet rriten çdo ditë, rritja dhe indeksimi i pagave është tërësisht i papërfillshëm.

Rritja e pagave është shumëfish më pak sesa rritja e çmimeve. Kjo çon në mënyrë të padiskutueshme në varfërimin e shoqërisë dhe të vendit. Nuk ka rritje të pensioneve, por vetëm 1,4% indeksim, që është shumë më i ulët, krahasuar me rritjen e pritshme të inflacionit si rrjedhojë e krizës. Sot një pensionist në qytet merr mesatarisht 15,7 mijë lekë të rinj, ndërsa një pensionist në fshat merr 9,2 mijë lekë të rinj. Minimumi jetik është afërsisht 18 mijë lekë të rinj. Kjo do të thotë që 650 mijë pensionistët, me pensionin aktual mund të klasifikohen automatikisht nën minimumin jetik. Kjo çon në një varfërim akoma më të madh. Edhe një gjë tjetër. Ne nuk dimë të mbajmë as detyrimin moral karshi prindërve tanë, atyre që kanë kontribuar për këtë vend. Të nderuar kolegë, Asnjë lek më shumë nuk do të ketë për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë, të cilët u persekutuan, u ekzekutuan, u burgosën dhe u internuan nga regjimi komunist. Mbi 5000 burra, rreth 500 gra, intelektualë, patriotë, klerikë u ekzekutuan nga regjimi komunist, u internuan familjarisht, iu rrëmbye pasuria dhe prona, iu shkatërruan familjet e tyre, por sot duhet të presin mëshirën e politikës që të përcaktojë, t'u kthejë atë që është e tyre. Buxheti i Autoritetit të Dosjeve duhet të rritet për disa arsye. Historia e përballjes me komunizmin në Shqipëri duhet të na kthejë kujtesën se si regjimi komunist luftoi kundër

lirisë, besimit dhe traditave. Duhet t'i japim mundësi që të bashkëpunojë me institucionet e tjera. Me miliarda dollarë është fatura e kompensimit të pronarëve.

Ndërsa me ritmet që keni përcaktuar me 20% të vlerës, do të duhen me dhjetëra vite për ta bërë këtë kompensim. Do të vlerësoj dhe mbështes çdo investim në sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes. Si vend anëtar i NATO-s, ne duhet të plotësojmë detyrimet tona për investime në mbrojtje 2% të GDP -së. Investimet në sigurinë kombëtare janë një hap në drejtimin e duhur dhe janë të domosdoshme. Kjo mbrojtje nuk është thjesht ushtarake, por përfshin të gjithë sektorët e rëndësishëm të ekonomisë. Investimi për emergjencat është nevojë e domosdoshme, që kërkon qartësisht të kuptohet se Forcat e Armatosura nuk janë dhe nuk mund të përdoren si Ndërmarrja e Pastrim – Gjelbërimit. Kjo do të bënte që FA-të të jenë të demotivuara dhe të mos kenë kualitetin që kërkohet. Të nderuar kolegë deputetë, Deklaroj se do të votoj kundër buxhetit vjetor për një arsye shumë të thjeshtë: ky buxhet e bën qeverinë më të madhe dhe qytetarin shumë, shumë më të vogël.